



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 1, datë 11.02.2025

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO, QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, Vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 % të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si më poshtë vijon:

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - Familja përpara se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Familjet me kryefamiljare gra, të veja, të divorcuara, me të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - Familje me kryefamiljare vajza nënë dhe me fëmijë nën 16 vjeç.
 - Të moshuar të vetmuar.
 - Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.

2. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të pushtetit vendor, si më poshtë vijon:

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
- Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.
- Familjet rome, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.



- Familjet me një anëtar, që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftushme.
 - Familjet me kryefamiljare gra, të cilat kanë të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.
3. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përlogaritet sipas Udhëzimit nr.4, datë 17.02.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.
 4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimit Drejtoria e Shërbimit Social.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.02.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 124/prot.

Durrës, më 18.02.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.1 datë 11.02.2025,” Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtezuar për bllok ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JAMI

